



MINISTRIA E BRENDSHME

AGJENCIA SHETËRORE E PROKURIMEVE TË PËRQËNDRUARA

Datë 21.11.2022

SQARIM

Organi Qendror Blerës, Agjencia e Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara, në datën 07.11.2022 ka publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedurën e prokurimit “Procedurë e kufizuar mbi kufirin e lartë monetar” me objekt “Blerje uniforma dhe kepuce për Policinë e Burgjeve”e ndarë në dy lote me **REF-48622-11-04-2022** me fond të përgjithshëm të marrëveshjes kuadër: 772,121,465 (shtatëqind e shtatëdhjetë e dy milion e njëqind e njëzetë e një mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë (pa TVSH) .

Në bazë të nenit 75, të Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Organi Qendror Blerës, Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara, sqaron të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: Blerje uniforma dhe kepuce për Policinë e Burgjeve”e ndarë në dy lote me **REF-48622-11-04-2022** me fond të përgjithshëm të marrëveshjes kuadër: 772,121,465 (shtatëqind e shtatëdhjetë e dy milion e njëqind e njëzetë e një mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë (pa TVSH) në lidhje me dorëzimin e dokumentacionit teknik si vijon:

Procedura është procedurë e kufizuar në zbatim të nenit 43 të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, sipas të cilit: *“Procedura e kufizuar është procedurë me dy faza, në të cilën mund të marrë pjesë çdo operator ekonomik i interesuar, duke dorëzuar një kërkesë për pjesëmarrje në përgjigje të një njoftimi, i cili përmban informacionin e përcaktuar në rregullat e prokurimit publik. Në procedurat e kufizuara mbi kufirin e lartë monetar, afati kohor minimal për marrjen e kërkesave për pjesëmarrje është jo më pak se 30 ditë nga data në të cilën është shpallur njoftimi i kontratës ose ftesa për shprehje interesi. Në fazën e dytë të procedurës së kufizuar, ofertë mund të paraqesin vetëm kandidatët e përzgjedhur nga autoriteti ose enti kontraktor, në përputhje me nenin 58 të këtij ligji. Autoriteti ose enti kontraktor mund të kufizojë numrin e kandidatëve të përshatshëm për t'u ftuar që të marrin pjesë në procedurë, në përputhje me parashikimet në këtë ligj. Në procedurat e kufizuara mbi kufirin e lartë monetar, afati minimal i përcaktuar nga autoriteti kontraktor për pranimin e ofertave është 30 ditë nga data në të cilën është shpallur ftesa për ofertë.”* si dhe të nenit 48 të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021 “Rregullat e Prokurimit Publik” sipas të cilit: *Pas mbylljes së fazës së parë të kualifikimit dhe në përfundim të afateve të ankimit, sipas parashikimit në nenin 110, të LPP-së, autoriteti/enti kontraktor fton kandidatët e përzgjedhur të dorëzojnë ofertat. Ofertat duhet të hartohen në bazë të specifikimeve teknike të përcaktuara në ftesën për ofertë, sipas afateve të përcaktuara në nenin 43, të LPP-së.*

Ne lidhje me pyetjen:

“Meqënëse lloji i procedurës është me dy faza kërkojmë të na sqaroni mostrat për mallrat e tabelës nr 1 do të dorëzohen në fazën e parë me dokumentacionin teknik apo në fazën e dytë, gjatë hapjes së ofertave ekonomike? “

Ju sqarojmë si vijon:

Në fazën e parë do të dorëzohen të gjitha dokumentat dhe mostrat e kërkuara në kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit. Pas mbylljes së fazës së parë të kualifikimit dhe në përfundim të afateve të ankimit duhet të hartohen ofertat ekonomike në bazë të specifikimeve teknike të përcaktuara në ftesën për ofertë.